



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 22.1.2022

Nr: 4

V E N D I M

P Ë R

**MIRATIMIN E PROCEDURAVE OPERACIONALE PËR SHKATËRRIMIN E TË  
DHËNAVE PERSONALE NË PAJISJEN ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT (PEI) DHE  
SISTEMIN ELEKTRONIK TË IDENTIFIKIMIT TË VOTUESVE (SEIV) NË KOMISIONIN  
QENDROR TË ZGJEDHJEVE, TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E  
SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 14, 19, pikat 1, shkronja “n”, dhe 2, 178, pika 6, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë“ të ndryshuar, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale” të ndryshuar dhe udhëzimit nr. 14, datë 22.12.2011, të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, “Për përpunimin, mbrojtjen dhe sigurinë e të dhënave personale në sektorin e komunikimit elektronik të publikut”, Komisioneri Shtetëror të Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

V E N D O S I N:

1. Miratimin e procedurave operacionale për shkatërrimin e të dhënave personale në pajisjen elektronike të identifikimit (PEI) në memorien e brendshme e USB, dhe në sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV), në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), të përdorura për identifikimin elektronik të zgjedhësve, në zgjedhjet për Kuvend të datës 25 Prill 2021, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Dokumentet e printuara nga pajisjet elektronike të identifikimit me të dhëna sensitive të zgjedhësve që ndodhen në kutitë e materialeve zgjedhore do të asgjësohen sipas nenit 178, pika 6 të Kodit Zgjedhor. Dokumentet e hapjes dhe mbylljes së procesit të votimit që kanë printuar pajisjet PEI do të dërgohen në Arkivin Qendror të Shtetit së bashku me dokumentacionit zgjedhor të përcaktuar në nenin 178, pika 6, të Kodit Zgjedhor.



Data: 22.1.2022

Nr. 4

“Për miratimin e procedurave operacionale për shkatërrimin e të dhënave personale në pajisjen elektronike të identifikimit (PEI) dhe sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”

3. Të dhënat biometrike për të cilat nga procesi i kryqëzimit të të dhënave ka rezultuar votim i shumëfishtë dhe është bërë kallëzim penal në organet përkatëse, të ruhen deri në përfundim të hetimit.
4. Komisioni i ngarkuar për asgjësimin e të dhënave ngrihet me urdhër të Sekretarit të Përgjithshëm të KQZ-së.
5. Procesi i asgjësimit të të dhënave sipas pikës 1 të këtij vendimi, bëhet në prani të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, partive politike, OJF-ve dhe medias.
6. Ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm dhe komisioni i ngritur sipas pikës 4, të këtij vendimi, për zbatimin e tij.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
8. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve.

**Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Lealba PELINKU**

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 22.1.2022

Nr. 4

“Për miratimin e procedurave operationale për shkatërrimin e të dhënave personale në pajisjen elektronike të identifikimit (PEI) dhe sistemin elektronik të identifikimit të votuesve (SEIV) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, të përdorura në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021”

**PROCEDURA OPERACIONALE PËR SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE  
PËR PAJISJET ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT (PEI) DHE SISTEMIN  
ELEKTRONIK TË IDENTIFIKIMIT TË VOTUESVE (SEIV) NË KOMISIONIN QENDROR  
TË ZGJEDHJEVE (KQZ), TË PËRDORURA NË ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS  
25 PRILL 2021**

Të dhënat personale që disponon KQZ për zhvillimin e zgjedhjeve si dhe të dhënat biometrike të mbledhura gjatë ditës së zgjedhjeve janë të ruajtura në:

1. Pajisjen e identifikimit elektronik PEI:
  - a. Memoria e brendshme
  - b. USB
2. Serverat e bazave të të dhënave në datacenter primar dhe sekondar.

Hapat që do ndiqen për shkatërrimin e materialeve elektronike pajisjeve të identifikimit elektronik PEI:

1. Çdo pajisje PEI do të kthehet në gjendje fabrike duke ndjekur procedurën e reset të pajisjeve elektronike me sistem operimi android si mëposhtë: Rregullime/Sistemi/Opsionet e mirëmbajtjes/spastro të gjitha të dhënat (rivendosja e fabrikës)/ shtyp Rivendos pajisje.
2. Të gjitha memoret USB të prodhuara gjatë zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021, do t'u fshihet informacion në mënyrë të përhershme nëpërmjet procesit të formatimit.
3. Serverat të cilët mbajnë rezultatet e identifikimit elektronik do t'ju fshihen të dhënat e bazës së të dhënave në mënyrë të pakthyeshme duke përdorur mjetet e ofruara nga baza e të dhënave.

I gjithë procesi i shkatërrimit të të dhënave elektronike dhe fizike do të monitorohet nga minimumi 3 (tre), punonjës të caktuar në grup pune për këtë qëllim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Grupi i punës në fund të procedurës do të dorëzojë procesverbalin ku konfirmon fshirjen e të dhënave elektronike dhe shkatërrimin e materialeve fizike sipas hapave të sipërpërmendur.



**PROCEDURA OPERACIONALE PËR SHKATËRRIMIN E TË DHËNAVE  
PERSONALE PËR PAJISJET ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT (PEI) DHE  
SISTEMIN ELEKTRONIK TË IDENTIFIKIMIT TË VOTUESVE (SEIV) NË  
KOMISIONIN QENDROR TË ZGJEDHJEVE (KQZ), TË PËRDORURA NË  
ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25 PRILL 2021**

Hapat që do ndiqen për shkatërrimin e materialeve elektronike pajisjeve të identifikimit elektronik PEI

1. Çdo pajisje PEI do të kthehet në gjendje fabrike duke ndjekur procedurën e reset të pajisjeve elektronike me sistem operimi android si mëposhtë: Rregullime/Sistemi/Opsionet e mirëmbajtjes/spastro të gjitha të dhënat (rivendosja e fabrikës)/ shtyp Rivendos pajisje.
2. Të gjitha memoriët USB të prodhuara gjatë zgjedhjeve për Kuvend të datës 25 Prill 2021, do t'u fshihet informacion në mënyrë të përhershme nëpërmjet procesit të formatimit.
3. Serverat të cilët mbajnë rezultatet e identifikimit elektronik do t'ju fshihen të dhënat e bazës së të dhënave në mënyrë të pakthyeshme duke përdorur mjetet e ofruara nga baza e të dhënave.

I gjithë procesi i shkatërrimit të të dhënave elektronike dhe fizike do të monitorohet nga minimumi 3 (tre) punonjës, të caktuar në grup pune për këtë qëllim, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve.

Grupi i punës në fund të procedurës do të dorëzojë procesverbalin, ku konfirmon fshirjen e të dhënave elektronike dhe shkatërrimin e materialeve fizike sipas hapave të sipërpërmendur.